

Nr. \_\_\_\_\_ Vendimit  
16388

16388

V E N D I M

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane sot me date 27.11.1996 une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane Gjykatja e Rrethit Tirane mpre ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkues Ministria e Bujqesise, "GREEK - ALBANIAN LEAF TOBACCO COMPANY" S.A., "LEAF TOBACCO A. MICHAILIDES" S.A. per regjistrimin si person juridik te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" SH.A. dhe

K O N S T A T O V A

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi per tu regjistruar si person juridik ne formen e Shoqerise Anonime "MIKABERAT" me ortake :

1. Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit
2. "Greek-Albanian Leaf Tobacco Company" S.A.
3. "Leaf Tobacco A. Michailides" S.A.

me seli ne qytetin e Beratit ,me kohe zgjatje per 30(tridhjet) vjet, me kapital themeltar 1.511.000 Dollare Amerikan ,me President Zotin ALEXANDROS J. MICHAILIDES, me objekt veprimtarie :Shfrytëzimin dhe rihovimin e kapacitetave akzistues te ish Fabrikes se Perpunimit te duhanëve Berat dhe te depove te saj, furnizimin dhe instalimin e maqinerive dhe pajisjeve bashkekohore per fermentimin natyral dhe artificial te duhanit, dhanien e ndihmes shkencore-agronomike per permiresimin e teknologjise se kultivimit te duhanit me synim rritjen e sasisë dhe cilesise se tij nga prodhuesit individual, rritjen e cilesise se duhanëve te fermentuara duke aplikuar teknologji te perparuara, te reja bashkekohore ne perpunimin dhe fermentimin e duhanit, te uentroj e odo veprimtari te ligjshme financiare dhe tregetare brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise ,veprimtari qe ka lidhje me pasurite e tunde dhe te patunde me te lidhura direkt ose indirekt me objektin e veprimtarise se Ndermarrjes se perbashket, qe konsiderohet e nevojshme dhe fitim preres per interesat ekonomike-financiare te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" ,eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Ne baze te Ligjit 7667 date 28.1.1993 dhe te Ligjit 7638 date 19.11.1992

V E N D O S I

Regjistrimin e person juridik te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" SH.A.  
me ortak :  
1. Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit  
2. "Greek Albanian Leaf Tobacco Company" S.A.  
3. "Leaf Tobacco A. Michailides" S.A.

me kapital themelues 1.811.000 Dollare Amerikane ,me ndara si me poshte:  
1. Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit 40 %  
2. "Greek Albanian Leaf Tobacco Company" S.A. 9 %  
3. "Leaf Tobacco A. Michailides" S.A. 51 %

me koha zgjatje 30 vjet ,me seli ne Berat,me President Z.Aleksander Mikailidhi  
me objekt veprimtarie: Shfrytëzimin dhe rinovimin e kapaciteteve ekzistuese te ish  
Fabrikeve se perpunimit te duhanave Berat dhe te depove te saj,frunizimin dhe insta-  
limin e makinerive dhe pajisjeve bashkekohore per fermentimin natyral dhe artificial  
te duhanit,dhënie e ndihmes shkencore-agronomike e per permesimin e teknologjise  
se duhanit me synim rritjen e sases dhe cilësis se tij nga prodhuesit individual,  
rritjen e cilësis se duhanave te fermentuara ,duke aplikuar teknologjine te perpa-  
ruara,te reja bashkekohore ne perpunimin dhe fermentimin e duhanit,te ushtroje c  
veprimtari te ligjshme financiare dhe tregtare brenda dhe jashte territorit te  
Republikes se Shqiperise,veprimtari qe ka lidhje me pasurit e tundshme dhe te patu-  
ndshme te lidhure direkt ose indirekt me objektin e veprimtarise se Shoqerise dhe  
qe konsiderohet e nevojshme ose fitimprures per interesat ekonomike-financiare te  
saj.

Organet Drejtuese te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" jane  
- Asambleja e Aksionareve (Ortakeve) me President Z. Aleksander Mikailidhi  
- Keshilli Mbikqyres  
- Drejtoria

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

G J Y Q T A R E

*(Dhimitër Capi)*

*Capi*

16389

shenime :

K O N T R A T E  
PËR KRIJIMIN E NDERMARJES SE PËRDOBSHKËT  
"MIKA-BERAT"

Ë lidhur ndërmjet polove:

1 - Ndërmarrje e Grupbëllim Përpunimit të Duhanit  
Berat regjistruar si person juridik me qender në Berat, e cila  
vepron në bazë të legjislacionit shqiptar, përfaqësohet nga  
Aristidh Haxhiuteg - Drejtor, shtetas shqiptar.

2 - Greek Albanian Leaf Tobacco Company - person  
juridik me qender në Selanik (Greqi), që vepron në bazë të  
legjislacionit Grek, përfaqësohet nga Aristidhis Lokeo, shtetas  
grek, businessman.

3 - Leaf tobacco - Michailides, - person juridik me  
qender në Selanik ( Greqi ) që vepron sipas legjislacionit  
grek, përfaqësohet nga presidenti i saj Alexandros Michailides,  
shtetas grek.


Te tre palët u morën vesh :

ARTI 1

Te krijohet një ndërmarrje të përbashkët greko-shqip-  
tare. Emërtimi i ndërmarrjes së përbashkët është "MIKA-BERAT".

ARTI 2

Ndërmarrja e përbashkët do të ketë selinë e vet në  
Republikën e Shqipërisë, në Berat. Ajo është person juridik  
shqiptar.



ARTI 3

Vlefshmëria e kësaj kontrate është për 30 vjet me te drejte ripërteritje nga palet.

ARTI 4

Veprimtaria e ndërmarrjes së përboshket do të zhvillohet në përputhje me dispozitat e kësaj kontrate, statutin e saj dhe legjisëlacionin shqiptar.

Statuti i ndërmarrjes së përboshket i bashkëlidhet kësaj kontrate është dhe pjesë përbërëse e saj.

ARTI 5

Mërmarrja e përboshket ka për objektiv kryesor:

1 - Shfrytësimin dhe rinovimin e kapaciteteve ekzistuese të fabrikës përpunuese të duhanit, të dopovo, të cilat aktualisht janë në procesin të ndërmarrjes së grumbullimit dhe përpunimit të duhanit. Bëhet që kapin një vlerë prej 277.000 (dyqindëstetëdhjetë e shtatë mijë) dollere USA dhe ushtrinë e duhanit gjendje aktualisht në ndërmarrje me vlerë 186.000 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) dollere USA. (Shih listën bashkëlidhur që është pjesë përbërëse e kontratës).

2 - Furnizimin dhe instalimin e makinorive, pajisjeve bashkohore për aktivitetin e shqerisë (ndërmarrjes) së përboshket që kapin një vlerë prej 1.000.000 (një milion e dyzet e tetë mijë) dollar USA të cilat do të furnizohen e vihen në punë nga Greek Albanian Leaf Tobacco Company dhe Leaf Tobacco Michailides S.A. (shih listën bashkëlidhur që është pjesë përbërëse e kontratës).

3 - Ne funksion te ecurise te ndermarjes së përbashket, brenda dy viteve të para te funksionimit të saj, të ndërtoje kapacitete te reja depozituese e përpunuese te duhanave ne për-  
puthje me teknologjine bashkekohore.

4 - Te ndihmoje ne teknologjine e kultivimit të duhanit me synim rritjen e sasisë dhe cilësisë së tij nga prodhuesit individual dhe shtetëror.

5 - Të aplikoje teknologji te reja bashkekohore ne përpunimin dhe fermentimin e duhanit .

6 - Te unetroje edhe veprimtari tregëtare dhe financiare, veprimtari ne lidhje me pasuritë e tundshme dhe të patundshme te lidhura direkt ose indirekt me objektin e veprimtarisë së ndermarjes së përbashket .

#### ARTIKULI 6.

Nderrmarja e përbashket do të ketë nje kapital prej 1.511.000 (nje milion e pesqind e njembeëdhjete mijë) dollar USA dhe përbëhet nga shuma të objekteve te vlerësuara si depo, ombjantot e makinerive, makinerite, lende e para etj . Pjesa e ortekëve ne kapital ne natyrë dhe vlerësuar ne USD është :

1 - Nderrmarja e Giumbullim Përpunim Duhanave Berat - 463.000 (katerqind e gjashtëdhjete e tre mijë) dollar USA baze me 30,64 % te kapitalit .

2 - Greco Albanian Leaf Tobacco Company Selanik - 151.000 (njëqind e pesëdhjete e nje mije) dollar USA baze me 10 % të kapitalit .

3 - Leaf Tobacco Michailides S.A.- Selanik - 897.000 (teteqind e nentëdhjete e shtato mijë) dollar USA, baze me 59,36 % të kapitalit .

4 - Në bazë të këtyre përpjestimeve të kontributit në kapital do të përcaktohen në të ardhmen edhe problemet e tjera ekonomike - financiare të ndërmarrjes së përbashkët .

Të dy palët grohe, duke emuar shërbimet e veçanta që do të ofrojnë shteti shqiptar ndaj Ndërmarrjes së Përbashkët "MIKABERAT" kështu në dobi të palës shqiptare 13.5 % të gjithë kapacitetit tyre .

Në këtë mënyrë, pjesët e kontributit të paleve në kapital dhe ndarje e fitimeve do të jete si më poshtë:

Ndërmarrja e Grupullim Përpunimit Duhani 40 % , Loaf Tobacco Micholidhis 51 % dhe Greece -Albanian S.A. 9 % .

Vlerësimi i kontributeve në natyrë bëhet në marrëveshje të përbashkët nga ortakët. Loaf Tobacco Micholidhis S.A. Selonik kontribon për zhvillimin e aktivitetit të ndërmarrjes së përbashkët edhe me shumën prej 100.000 (njëqindmijë) dollar USA, të cilat ja jep ndërmarrjes së përbashkët në formë huaje, me kusht kthimi pas 2 vjetëve, pa përqindje fitimi. Gjate ekzekutimit të kësaj kontrate shumë dhe mënyrë e vlerësimit të kontributeve do të jete përfundimtare dhe vlera do të shprehet në dollar USA.

Ndërmarrja e përbashkët, për nevojat e ushtrimit të aktivitetit të saj do të çelë llogori në Bankën e Shtetit shqiptar ose në bankat e tjera të njohura me ligj në Republikën e Shqipërisë. Në librin e llogaritë në ndërmarrjes së përbashkët "Krijohet fondi themelor i ortakëve" ku shënojnë kapitulet e vona nga secili ortak në natyrë .

ARTI 7

Ne kohën e lidhjes së kësaj kontrate Mërmorja e Grumbullim Përpunimit të Duhurit Berat i detyrohet degës së Bankës së Shtetit Shqiptar Berat shumë prej 20.669.000 lekë (njetzet milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lek nga të cilat : 12.700.000 lek janë marrë si kredi fillestare me interes fitimi për bankën sipas aktit të detyrimit, 9 %, 2.439.000 lek tërhequr për paget e punctorëve për periudhën deri 30.06.1992, 500.000 mijë lekë detyrime ndaj ndërmarrjes së Grumbullimit Drithe TR, Berat për blerjen lende të pazë (duhan), 5.000.000 lekë për blerjen e një prece tëngim duhani NFILU Durres dhe 30.000 lekë për shpenzimet e bazamentit të kaldejes.


Te tre polot orriten në marrëveshje të kalojnë, në masën në të cilën, si detyrime të ndërmarrjes së përbeashket.

Te tre polot rano dakort që, përveç detyrimit në shumën 20.669.000 lek, ndërmarrja e përbeashket nuk do të njohë dhe nuk do të marrë përsiper asnjë detyrim tjetër që mund të pretendohet nga Banka e Shtetit ose Banka të tjera, ndërmarrja të tjera shtetërore ose private dhe individë të veçantë si edhe organe të tjera shtetërore e detyrime nga vendime gjyqësore.

ARTI 8

Mërmorja e përbeashket e fillon veprimtarinë e saj pas marrjes së miratimit me shkri (autorizimit) nga organi kompetent i shtetit shqiptar.


Fitimi i ndërmarrjes së përbeashket do të rezultojë pas shërbimit nga volumi i përgjithshëm tregëtor vijator i tërësive së detyrimeve të të gjitha llojeve që lidhen me veprimtarinë e saj

.. 

dhe qe përbëhen prej shpenzimeve ne materiale e lende te pare, investime, amortizime, shpenzime financiare, fond paga, taksa, etj.

Fitimi neto i rezultuar do të ndahet midis palëve ne proporcion me pjesën që i takon çdo ortaku ne kontributin e dhene për krijimin e kapitalit të përcaktuar ne nenin 6 te kësaj kontrate.

Pjesa e fitimit që u takon ortakëve te huaj ( jo shtetes shqiptare), mund të transferohet lirshem jashte Shqiperise ne lek shqiptare ose valute te huaj, pasi te jene paguar takset eventuale te parashikuara nga legjislacioni i Shtetit Shqiptar.



Pollet rano dakort që problemet e punonjësve ne ndërmarrjen e përbashket te trajtohen ne akt-marrevechje te vecante ne secilin punonjes, sipas legjislacionit shqiptar.

#### NENI 10

Greece Albanian Leaf Tobacco Company and Leaf Tobacco Michailides S.A. marrin për sipër që, duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, ti japin foles ndërmarrjes ne Grumbullim Përpunim Duhanëve Berat shumën 20.000 dollare USA për pagat e punonjësve të saj deri më 31.12.1992. Ndërmarrja e Grumbullim Përpunim Duhanit Berat merr për sipër detyrimin që ne rast mos miratimi nga organet kompetente shqiptare te krijimit te ndërmarrjes se përbashket MIKA - BERAT S.A. deri më 31.08.1992, tu ktheje Greece Albanian Leaf Tobacco Company dhe Leaf Tobacco Michailides S.A shumën 20.000 mijë dollare USA dhene si

./.

mësipër në dollaro USA ose duhane.

### ARTIKULI 11

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga polot Greco Albanian Leaf Tobacco Company dhe Leaf Tobacco Mihalides S.A. marrin përsipër që të përgatitin makinerite dhe pajisjet e reja për rikonstruksionin e teknologjise së përpunimit të duhanëve në mjediset e ndërmarrjes së Grumbullim Përpunim Duhaneve në Berat vendosja e të cilave do të fillojë pas miratimit nga organet kompetente shtetërore shqiptare të krijimit të kësaj ndërmarrje. Instalimi i makinerive dhe pajisjeve do të përfundojë brenda 6 muajve nga data e këtij miratimi.

### ARTIKULI 12

Që rast se organet kompetente shtetërore shqiptare nuk japin miratimin për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët TKA-BERAT S.A. deri më 31.03.1992. Greco Albanian Leaf Tobacco Company dhe Leaf Tobacco Mihalides S.A. tërhiqen nga kjo kontratë, duke i konsideruar kushtet e kësaj kontrate kryesisht të pagëna.

### ARTIKULI 13

Organet e ndërmarrjes së përbashkët që rregullojnë veprimtarinë e saj përbëtohen në statutin që bashkëlidhet kësaj kontrate.

### ARTIKULI 14

Polot cotohen të bashkëpunojnë me vullnet të mirë e besim reciprok me qëllim realizimin e objektit të kësaj kontrate.

Cdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin, vlefshmërinë ose zbatimin e kësaj kontrate do të zgjidhet në

Arbitrozhin e Dhomës Ndërkombëtare të Tregëtisë në Parisit në përputhje me legjislacionin Zvicerian.

NEML 15

Kjo kontratë është hartuar në gjuhën shqipe dhe angleze dhe këto vlera të barabarta në interpretimin dhe zbatimin e kontratës. Në rast interpretimi kontradiktor, gjuha baze do të jetë anglezja.

NG.P. DUHANIT BERAT

GREEK ALBANIAN LEAF TOBACCO S.A.

LEAF TOBACCO MICHAELIDES S.A.

*Res. Michaelides*

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
NOTERE MANUSHAQE SELMANI

Nr. 2976

Berat, më 06.11.1996

V E R T E T I M

Vërtetohet se dokumenti i fotokopjuar është i njëjtë me origjinalin.

N O T E R E

Manushaqe Selmani

*Takim  
u pagu  
[Signature]*



*[Signature]*

# STATUTI

## I SHOQERISE ANONIME "MIKABERAT" SH.A

SHOQERIA ANONIME "MIKABERAT" SH.A krijohet me Vendimin date 12.06.1995 te Asamblese se Ortakeve te Ndermarrjes se Perbashket te Grumbullim Perpunim Duahneve "MIKABERAT", e cila vendosi te shnderroje "MIKABERATIN" nga nje ndermarrje e perbashket (Joint-Venture), ne Shoqeri Anonime, pasi shqyrtoi dhe miratoi RAPORTIN MBI GJENDJEN E SHOQERISE, perpiluar nga Z.Petraq Qyli dhe Agim Isaku si Eksperte per shnderrimin ne baze te Nenit 77 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "PER SHOQERITE TREGETARE".

### Neni 1

Ne baze te Kontrates date 10.07.1992 Ortake te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" jane:

1. Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit te Republikes se Shqiperise, e cila ka patur ne vartesi ish Ndermarrjen e Grumbullim Perpunimit te Duaneve Berat, perfaqesuar me Prokure te posacme nga Zoti Vasillaq Nika.

2. "Greek - Albanian Leaf Tobacco" Company, Person Juridik me qender ne Selanik (Greqi), perfaqesuar me Prokure te posacme nga Zoti Aristidhis Lekas, Shtetas Grek, Biznesmen.

3. "Leaf - Tobacco A.Michailides" S.A, Person Juridik me qender ne Selanik (Greqi), perfaqesuar nga Presidenti i saj Zoti Alexander Michailides, Shtetas Grek.

### Neni 2

Shoqeria Tregetare "MIKABERAT" SH.A eshte shoqeri pa Oferte Publike. Ajo zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dipozitat e ketij Statuti, si dhe marreveshjes se arritur me Kontraten date 10.07.1992, neneshkruar prej Ortakeve.

### Neni 3

Emertimi i Shoqerise eshte "MIKABERAT" SH.A. Selia e saj ndodhet ne Shqiperi ne Qytetin e Beratit.



#### Neni 4

Kapitali themeltar i Shoqerise "MIKABERAT" SH.A. eshte 1.511.000 (njemilion e peseqind e njembdhjete mije) USD. Ortaket marrin pjese ne krijimin e kapitalit themeltar me kuotat ne natyre dhe monedhe, sipas percaktimit ne Kontraten date 10.07.1992, i cili perbehet nga shuma e objekteve te vleresuara si depo, ambjentet e makinerive, trualli mbi te cilin jane ndertuar ato, makinerite per fermentimin natyral te duhanit, pajisje te ndryshme, lende te pare etj. Pjesa e kontributit te Ortakeve ne kapital ne natyre, te vleresuara ne USD eshte sipas pecaktimeve te nenit 6 te Kontrates date 10.07.1992 dhe te Nenit 7 te ketij Statuti.

#### Neni 5

Shoqeria Tregetare "MIKABERAT" SH.A ka per objektiv kryesor:

1. Shfrytezimin dhe rinovimin e kapaciteteve ekzistuese te Fabrikes se Perpunimit te Duhanit Berat, te depove qe ne momentin e neneshkrimit te Kontrates ishin ne pronesi te ish - Ndermarrjes se Grumbullim Perpunim Duhanit Berat.

2. Furnizimin dhe Instalimin e makinerive e pajisjeve bashkekohore per fermentimin natyral te duhanit.

3. Dhenien e ndihmes shkencore- agronomike per permiresimin e teknologjise se kultivimit te duhanit me synim rritjen e sasise dhe cilesise se tij nga prodhuesit individuale.

4. Te rrishte cilesine e duhaneve te fermentuara duke aplikuar teknologji te perparuara, te reja bashkekohore ne perpunimin dhe fermentimin e duhanit.

5. Te ushtroje veprimtari te ligjeshme dhe tregetare, sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi, brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise, veprimtari qe ka lidhje me pasurite e tundeshme e te patundeshme te lidhura direkt ose indirekt me objektin e veprimtarise se Ndermarrjes se Perbashket, qe konsiderohet e nevojshme ose fitimprurese per interesat ekonomike - financiare te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" SH.A.

#### Neni 6

Kohezgjatja e Shoqerise eshte percaktuar per 30 (tridhjete) vjet. Aktiviteti i saj filloi me 15.10.1992, pas marrjes se Autorizimit Nr.43, date 1.09.1992 te ish Ministrise se Tregetise dhe Marredhenieve Ekonomike me Jashte dhe Vendimit date 15.09.1992 te Gjykates se Rrethit Berat qe e njohu ate si person juridik. Ky afat mund te perseritet ne marreveshje midis Ortakeve ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Veprimtaria e Shoqerise Tregetare "MIKABERAT" SH.A pushon para ketij afati vetem me vendim unanim (te njezeshem) te Ortakeve dhe ne rastet e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar.





## Neni 7

### A. KONTRIBUTET

Kontributet ne kapitalin themeltar te Shoqerise Tregetare "MIKABERAT" SH.A jane ne natyre, te vleresuara ne USD dhe te ndara ne aksione sic percaktohet me poshte:

1. Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit e Republikes se Shqiperise (ish Ndermarrja e Grumbullim Perpunim Duhanëve Berat) kontribuon ne Shoqeri me 604.400 USD qe u pergjigjen 6044 aksioneve me vlefte rreth 100 (njqind) USD secili, baraz me 40 perqind te kapitalit.

2. "Greek - Albanian Leaf Tobacco" Company, kontribuon ne Shoqeri me 135.900 USD qe u pergjigjen 1360 aksioneve me vlefte rreth 100 (njqind) USD secili, baraz me 9 perqind te kapitalit.

3. "Leaf - Tobacco A.Michailides" S.A, kontribuon ne Shoqeri me 770.610 USD qe u pergjigjen 7706 aksioneve me vlefte rreth 100 (njqind) USD secili, baraz me 51 perqind te kapitalit.

Gjate punes per kompletimin e investimit, Ortaku i huaj "Leaf - Tobacco A.Michailides" S.A, pervec detyrimeve kontraktuale, ka sjelle dhe pajisje, makineri e sherbime te tjera ekstra ne vleften 568.000 USD, te cilat do te konsiderohen si hua pa interes, e marre nga "MIKABERAT" SH.A.

### B. KAPITALI

Kapitali themeltar eshte 1.511.000 USD i ndare ne 15.110 Aksione Nominative me vlere 100 UAD secili, te se njejtës Klase dhe Numer Serie nga 1 deri 15110 nga te cilat:

6044 aksione, me Numer Serie nga 1 deri 6044 i jepen Ministrise se Bujqesise dhe Ushqimit te Republikes se Shqiperise

1360 aksione, me Numer Serie nga 6045 deri 7404 i jepen "Greek - Albanian Leaf Tobacco" Company

7706 aksione, me Numer Serie nga 7405 deri 15110 i jepen "Leaf - Tobacco A.Michailides" S.A

## Neni 8

Aksionet jane plotesisht te shlyeshme dhe te formes nominative. Ato jane te pakthyeshe perkundrejt shoqerise. Shlyerja e aksioneve mund te behet ne nje Banke Shqiptare (shteterore ose private) ose ne nje Banke te Huaj sipas percaktimeve te legjislacionit shqiptar ne fuqi.





Nenshkrimet e aksioneve dhe shumat e derdhura evidentohen ne nje certifikate te dhene nga Bankat e lartpermendura. Ne rast humbje te Certifikates Nominative, Mbajtesi (Aksioneri) i tij duhet te njoftoje Shoqerine Anonime (Administraten) dhe te publikoje nje Deklarate Personale per humbjen ne nje fletore Zyrtare te botuar ne Republiken e Shqiperise ose te ndonje vendi tjeter ku ndodhet banka ne te cilen eshte parashikuar se mund te shlyhen aksionet.

Per nje periudhe prej nje viti nga ky publikim, Aksioneri nuk mund te kerkoje pagimin e asnje Dividenti. Me kalimin e ketij afati, ne rast se certifikata nuk eshte gjetur, Aksionerit i leshohet nje dublikate e certifikates se humbur.

Shpenzimet e kesaj procedure, i ngarkohen Aksionerit qe ka humbur certifikaten.

#### Neni 9

Ne rast se perfshirja ne kapital e Rezerveve, fitimeve, ose Primeve te Emetimit, shoqerohet me dhenien e Aksioneve te reja Aksionereve te shoqerise, e drejta e perparesis se eshte e tregetueshme, me perjashtim te rastit kur e vendos shprehimisht Asambleja ne kushtet e parashikuara nga Paragrafi II i Nenit 152 te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare".

Ne rast se njeri prej ortakeve deshiron te shese pjesen e vet ne kapital, ai duhet t'ia ofroje me perpara ortakeve te tjere dhe ne rast se ata nuk pranojne ta blejne, ortaku qe kerkon te shese, ka te drejte t'ia ofroje cdo personi tjeter me kusht qe cmimi per te tjeret te mos jete me i ulet se ai me te cilin i eshte ofruar ortakeve te tjere te Shoqerise.

#### Neni 10

Shoqeria Tregetare mban nje regjister te vecante ne te cilin regjistron:

- Aksionet Nominative me treguesit perkates te operacioneve te transferimit dhe te shnderrimit te aksioneve.

- Datat e operacioneve.

- Emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit te vjeter dhe te ri ( ne rast transferimi) te Titullareve te Aksionit.

- Emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit te Titullareve te Aksionit ne rast shnderrimi te aksioneve (nga Nominative ne Aksione per Pruresin dhe anasjelltas).

- Vlera minimale dhe numri i Aksioneve te transferuar dhe te shnderruar.





#### Neni 11

Me perjashtim te rasteve te trashegimise, transferimi i pronesise mbi aksionet nje personi te trete, pavaresisht nga baza juridike e ketij transferimi, mund te behet vetem me pelqimin e Ortakeve te Shoqerise "MIKABERAT" SH.A, dhene ne kushtet e parashikuara nga Neni 207 i Ligjit Nr.7638, date 19.01.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe te Nenit 9 te ketij Statuti.

#### Neni 12

Organet Drejtuese te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" SH.A jane:

- Asambleja e Pergjitheshme (Aksionereve)
- Keshilli Mbiqyres
- Drejtoria

#### Neni 13

Organi Vendimor i Shoqerise Tregetare "MIKABERAT" SH.A eshte Asambleja e Pergjitheshme. Ky organ mblidhet ne mbledhjet e zakoneshme te tij te pakten nje here ne vit brenda 6 muajve qe pasojne mbylljen e vitit finaciar. Mbledhja e zakoneshme e Asamblese se Pergjitheshme thirret nga Keshilli Mbiqyres ose Drejtoria. Ne mungese, ajo mund te thirret gjithashtu nga:

- Ekspertet Kontabel te autorizuar.
- Likuidatoret.

Thirrja e Mbledhjes se Asamblese se Pergjitheshme behet nepermjet lajmerimit me shkrim te pakten 15 dite perpara, duke njoftuar edhe rendin e dites. Asambleja e Pergjitheshme mund te thirret edhe ne mbledhje te jashtezakoneshme kur kete e kerkon 2/3 e anetareve te saj, per te shqyrtuar ceshtje te kompetences se saj. Mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme, pervec vendit ku ka seline Shoqeria Anonime "MIKABERAT" SH.A, mund te thirret ne nje vend tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise ose jashte ketij territori.

#### Neni 14



Aksioneret qe marrin pjese ne mbledhjet, vete ose me perfaqesim agjor, kane te drejte vote ne proporcion me numrin e aksioneve qe zoterojne. Cdo aksioner jep te drejten e nje vote. Per te qene e vlefshme (Mbledhja e Asamblese se Pergjitheshme) ne mbledhjet e saj duhet te jene te pranishem ose te jene te perfaqesuar mbi 1/2 e aksionereve. Cdo aksioner ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese.



#### Neni 15

Asambleja e Aksionereve (Ortakeve) ka kompetence te vendose:

a. Per emerimin e 2/3 te anetareve te Keshillit Mbiqeqyres.

b. Per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise Anonime.

c. Per zmadhimin ose zvogelimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise.

d. Per zgjatjen ose pushimin e veprimtarise se Shoqerise perpara afatit te parashikuar ne Nenin 6 te ketij Statuti dhe likuidimin e saj.

e. Shqyrton raportin e Drejtorise per llogarite vjetore.

f. Shqyrton rezultatet financiare te Shoqerise.

Vendimet per ceshtjet e parashikuara nga pikat b, c, d te ketij Neni merren me votat e 3/4 te Aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar. Vendimet per ceshtjet e tjera merren me 1/2 e votave te Aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar.

#### Neni 16

Keshilli Mbiqeqyres i Shoqerise Anonime "MIKABERAT" SH.A perbehet nga 9 anetare, 2/3 e te cileve emerohen nga mbledhja themeluese e Asamblese se Pergjitheshme ose nga mbledhje e zakoneshme e saj.

Kohezgjata e anetareve te Keshillit Mbiqeqyres te emeruar nga Asambleja percaktohet 6 vjet. Asnje anetar i Keshillit Mbiqeqyres nuk mund te jete anetar i Drejtorise.

Nje e treta e anetareve te Keshillit Mbiqeqyres zgjidhet nga te punesuarit ne Shoqerine Anonime "MIKABERAT" SH.A, te cilet duhet te jene nga radhet e te punesuarve qe kane neneshkruar kontrate pune te pakten dy vjet perpara dates se emerimit ne kete Keshill.

Te gjitha te punesuarit e Shoqerise, qe kane lidhur kontrate pune ne kete shoqeri mbi tre muaj para dates se zgjedhjeve, konsiderohen zgjedhes per efektet e paragrafit parardhes te ketij Neni.

Kandidatet paraqiten me firmen e 1/20 te numrit te pergjitheshem te te punesuarve te Shoqerise. Votimi behet i fshehte. Ne rast barazimi votash, kandidati qe ka kontraten me te vjeter te punes konsiderohet fitues. Mandati i anetareve te Keshillit Mbiqeqyres te zgjedhur nga te punesuarit eshte i papajtueshem me cdo mandat tjeter perfaqesues te te punesuarve te Shoqerise.

Prishja e kontrates se punes me Shoqerine Anonime "MIKABERAT" SH.A. i jep fund mandatit te zgjedhur nga te punesuarit. Kohezgajtja e anetareve te zgjedhur nga te punesuarit percaktohet 3 vjet.





dy kategorite e anetareve te Keshillit Mbikeqyres, me plotesimin e afatit te parashikuar si me siper mund te rizgjidhen.

Ne rastin e vendeve bosh qe krijohen nga doreheqja, vdekja ose forca te tjera madhore te nje apo disa anetareve te Keshillit Mbikeqyres, vete ky Keshill mundet qe, per periudhen midis dy Mbledhjeve te Asamblese te beje emerime te perkoheshme.

#### Neni 17

Keshilli Mbikeqyres zgjedh nga gjiri i vet nje Kryetar dhe nje Zevendekryetar. Ata drejtojne mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres dhe debatin ne to.

Asambleja mund t'u caktoj Anetareve te Keshillit Mbikeqyres si shperblim nje shume fikse per pjesemarrjen e tyre ne seancat e ketij Keshilli, si dhe shperblime te jashtezakoneshme per sherbimet apo detyrat qe u besohen atyre per te kryer.

#### Neni 18

Keshilli Mbikeqyres mund te marre vendime vetem kur ne mbledhjet e tij jane te pranishem, te pakten gjysma e anetareve te tij ose perfagesuesve te tyre. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem ose perfagesuesve te tyre.

#### Neni 19

Keshilli Mbikeqyres ka keto kompetenca:

- Emeron dhe shkarkon anetaret e Drejtorise, duke ngarkuar njerin prej tyre me cilesine e Drejtorit.

- Ushtron kontroll te vazhdueshem mbi Drejtorine lidhur me administrimin e Shoqerise prej saj.

- I paraqet Mbledhjes se Asamblese se Aksionereve konkluzionet e shqyrtimit te raportit vjetor te Drejtorise per llogarite vjetore.

- Zgjedh nga gjiri i saj Kryetarin dhe Zevendekryetarin.

Mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres jane te vlefshme vetem kur ne to marrin pjese mbi 1/2 e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice votash te mbi 1/2 te anetareve te pranishem ose te perfagesuar.

Ne rast rezultati te barabarte votash, vota e Kryetarit dhe Zevendekryetarit eshte vendimtare. Anetaret e Keshillit Mbikeqyres mund te marrin pjese, me Vote Konsultative, ne te gjitha mbledhjet e Asamblese se Aksionereve (Ata kane vote vendimore ne Asamble vetem kur e zoterojne ate ne cilesine e aksionerit)





#### Neni 20

Shoqeria Anonime "MIKABERAT" SH.A drejtohet nga nje Drejtori e perbere nga Drejtori dhe Zevendezdrejtori, te cilet emerohen dhe shkarkohen nga Keshilli Mbiqyres, i cili cakton dhe shperblimin e tyre.

Kohezgjatja e mandatit te Drejtorit dhe Zevendesdrejtorit te "MIKABERAT" SH.A eshte 3 vjet, me te drejte perseritje.

#### Neni 21

Drejtorja ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" SH.A. Kompetencat e saj i ushtron brenda objektit te veprimtarise se Shoqerise, parashikuar ne Nenin 5 te ketij statuti.

Drejtorja nuk ka te drejte te ushtroje ato kompetenca qe, sipas Ligjit dhe Statutit, u jepen vetem Asamblese dhe Keshillit Mbiqyres.

Drejtorja shqyrton ceshtjet dhe merr vendime ne menyre kolegjiale.

Vendimet e Drejtorise qe kane te bejne me probleme ekonomike-financiare te rendesishme, me organizimin e punes dhe fuqine punetore si dhe ato per te cilat kerkohet nga vete Kryetari i Keshillit Mbiqyres qe para se te merret pelqimi i tij, nuk mund te merren pa u marre me pare pelqimi i ketij te fundit. Shoqeria Anonime "MIKABERAT" SH.A ne marredheniet me te tretet, merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e Drejtorise edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e Shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper detyrimet ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i Drejtorise e kalonte objektin e Shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete fakt ne rrethanet e dhena.

Te drejten e perfaqesimit te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" SH.A. ne marredhenie me te tretet e kane si Drejtori dhe Zevendezdrejtori i Shoqerise.

#### Neni 22

Drejtorja cdo tre muaj i paraqet raport Keshillit Mbiqyres per veprimtarine e saj, ndersa, pas mbylljes se vitit financiar i paraqet raport Asamblese se Aksionereve per gjendjen ekonomike-financiare te Shoqerise.



#### Neni 23

Shoqeria Tregetare "MIKABERAT" SH.A do te kete 3 eksperte kontabel te autorizuar, 2 prej te cileve caktohen nga ortaket greke dhe njeri nga ortaku shqiptar.



Ekspertet kontabel te autorizuar kane per detyre te ushtrojne kontroll per ushtimin e veprimtarise financiare te Shoqerise "MIKABERAT" SH.A ne perputhje me ligjin. Sistemi i kontabilitetit qe do te perdore Shoqeria Anonime "MIKABERAT" SH.A, do te jete ai qe percaktohet ne legjislacionin shqiptar. Per me teper, mund te perdoren edhe kerkesa plus per sistemin e kontabilitetit, kur nuk vijne ne kundershtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi, kur ato konsiderohen te nevojshme ne perputhje me vendimin e Keshillit Mbikeqyres, per te ndihmuar aksioneret e huaj te Shoqerise.

#### Neni 24

Problemet e punesimit, marredheniet me Sindikatat dhe probleme te tjera ne lidhje me marredheniet e punes ne Shoqerine Anonime "MIKABERAT" SH.A, do te zgjidhen ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, duke patur ne baze Kontraten Kolektive te punes dhe Kontraten Individuale te punes me te punesuarit ne Shoqeri. Ne Shoqerine Anonime "MIKABERAT" SH.A mund te punesohen edhe shtetas te huaj, te cilet do t'i neneshtrohen legjislacionit shqiptar per marredheniet e punes. (Shih Nenin 3 te Ligjit 7764, date 2.11.1993 "Per Investimet e Huaja").

#### Neni 25

Ortaket, shtetas te huaj te Shoqerise Anonime "MIKABERAT" SH.A, kane te drejten te transferojne jashte territorit te Republikes se Shqiperise te gjitha fondet dhe Kontributet ne Natyre ne kete Shoqeri si:

a. Te ardhurat dhe fitimin qe u takon.

b. Kompensimin sipas Nenit 5 te Ligjit Nr.7764, date 2.11.1993 "Per Investimet e Huaja".

c. Pagesat qe mund te rrjedhin si pasoje e nje mosmarreveshje investimi sipas ketij Statuti dhe Kontrates 10.07.1992.

d. Pagesat qe kryhen sipas nje Kontrate, duke perfshire dhe pagesat e huase dhe te interesit qe kryhen ne perputhje me nje marreveshje huaje.

e. Te ardhurat qe rezultojne nga shitja ose likuidimi i pjeshshem ose i plote i investimit te bere sipas ketij Statuti dhe Kontrates 10.07.1992.

f. Te ardhurat qe rezultojne nga zvoglimi i kapitalit te Shoqerise ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Ortaket, shtetas te huaj, kane te drejten te kryejne keto transferime jashte territorit te Republikes se Shqiperise ne monedhe lehtesisht te konvertueshme, llogaritur me kursin e shkembimit per transaksionet e castit ne ditën e transferimit, ne monedhen qe do te transferohet, sipas dispozitave ligjore ne fuqi te Republikes se Shqiperise.





Neni 26

Cdo mosmarreveshje dhe pretendim qe buron ose ka lidhje ose referohet tek ku Statut dhe Kontrata date 10.07.1992, do te zgjidhet ekskluzivisht nga Arbitra, dhe ne baze te rregullores se Dhomes Nderkombetare te Tregetise se Parisit dhe ne baze te besimit te mire (ex aucto et bono).

Mosmarreveshjet ne lidhje me marredheniet e punes do te zgjidhen ne gjykatat shqiptare ne baze te legjislacionit shqiptar.

Te gjitha mosmarreveshjet qe kane lidhje me mbrojtjen e investimit do te zgjidhen ne Arbitrazhin e Dhomes Nderkombetare per Investimet (Qendra) ne baze te Marreveshjes per Zgjidhjen e Mosmarreveshjeve midis shteteve dhe shtetasve te shteteve te tjera qe eshte neneshkruar ne Washington ne Mars 1965, gjithashtu edhe ne baze te marreveshjes ekzistuese midis Greqise dhe Shqiperise.

Neni 27

Ky Statut eshte perpiluar ne gjuhet shqip dhe anglisht qe kane vlere te barabarte ne interpretimin dhe zbatimin e tij. Eshte perpiluar ne 4 (kater) kopje ne shqip dhe 4 (kater) kopje ne anglisht.  
Ne rast interpretimi kontradiktor, gjuha baze do te jete gjuha angleze.

Neneshkruar ne Tirane, me 22.11.1996

Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit, Tirane, ALBANIA

(VASILLO NIKI)

"Leaf - Tobacco A. Michailides" S.A Thessaloniki, GREECE

Vasilis H. Konstantinou



"Greek- Albanian Leaf Tobacco" Company Thessaloniki, GREECE

Vasilis H. Konstantinou